



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 14.5.2023

Nr: 525

Ora: 12:30

VENDIM

PËR

PAJISJEN E QENDRËS SË VOTIMIT NR.2275/1, KZAZ NR. 44, BASHKIA PEQIN, ME SASINË SHITESË TË FLETËVE TË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 43, nenit 62, pika 2, nenit 93, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Sipas komunikimit me Komisionin e Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve nr. 44, Bashkia Peqin, në qendrën e votimit nr. 2275/01, është konstatuar mungesë e fletëve të votimit për kandidatin për kryetar bashkie dhe do t’i tërheqë nga qendrat e votimit nr. 2275/00, nr. 2272/00 dhe nr. 2272/01.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të autorizojë KZAZ nr. 44, Bashkia Peqin, që të tërheqë nga qendrat e votimit nr. 2275/00, nr. 2272/00 dhe nr. 2272/01 fletë votimi për kandidatin për kryetar bashkie. Në këto kushte, KQZ duhet të marrë masa të sigurojë sasi shtesë të fletëve të votimi për të mundësuar votimin për kandidatin për kryetar bashkie.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 43, nenin 62, pika 2, nenin 93, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 14.5.2023 Nr: 525
Ora: 12:30



“Për pajisjen e qendrës së votimit nr.2275/1, KZAZ nr. 44, Bashkia Peqin, me sasinë shtesë të fletëve të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

V E N D O S:

1. Autorizimin e KZAZ-së nr. 44, Bashkia Peqin, që të pajisë me sasinë shtesë të fletëve të votimit, qendrën e votimit nr. 2275/01.
2. Autorizimin e KZAZ-së nr. 44, Bashkia Peqin, të pajisë këtë qendër me 300 (treqind) fletë votimi për kandidatin për kryetar bashkie. Sasia shtesë e fletëve të votimit do të merret nga qendrat e votimit nr. 2275/00, nr. 2272/00 dhe nr. 2272/01, të KZAZ nr. 44, Bashkia Peqin.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të KQZ-së.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI